



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: Filozofi dhe Sociologji

Varianti A

Pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	D	A	B	B	C	C	B	B	A	B
Pyetja	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27
Përgjigja e saktë	D	D	B	C	A	B	D	A	B	A

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikët, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Sociologji

Pyetja 11 2 pikë
Model përgjigje

• Shoqëror

Respektimi i moreve është shumë i rëndësishëm. Mosrespektimi shoqërohet me reagime të ashpra shoqërore. Shoqëria bën kontrolle të vazhdueshme të këtyre normave.

• Ligjor

Duke qenë se janë norma shumë të rëndësishme, ato sanksionohen edhe ligjërisht. Organet shtetërore përcaktojnë penalitetet në rast shkelje të këtyre normave.

2 pikë nëse shpjegon rëndësinë e normave shoqërore dhe ligjore;

1 pikë nëse shpjegon rëndësinë e normave shoqërore ose ligjore;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 3 pikë
Model përgjigje

• Dëshmia e diversitetit dhe pluralizmit, zgjerimi i të drejtave për pakicat janë tipare themelore të një shoqërie e cila i jep rëndësi drejtësisë sociale. Në ditët e sotme respektimi i grupimeve që kanë në fokus të drejtat e grave, mbrojtjen e mjedisit, trajtohen me prioritet për të krijuar mundësinë e zbatimit të projekteve, hartimit të projektligjeve, etj., duke vlerësuar rëndësinë e diskutimeve dhe ideve për barazi sociale.

- Në shoqërinë pasmoderne ka një skepticizëm ndaj institucioneve, autoriteteve dhe njohurive që vijnë nga ekspertët, qofshin këta edhe profesionist që mbështeten në shkencë. Në shoqërinë e sotme vihet re një ristrukturim i institucioneve, nën ndikimin e revolucionit të informacionit. Madje edhe vetë institucioni i familjes në ditët e sotme paraqitet në disa modele. Nga ana tjetër shkenca nuk ka arritur të zgjidhë problemet më kryesore që lidhen me shëndetin dhe gjithashtu ka ndikuar në përkeqësimin e shëndetit lidhur me sëmundjet profesionale, dëmtimin e mjedisit, etj.
- Zbehja e dritës së përparimit: mungon optimizmi që karakterizonte shoqërinë moderne dhe në këtë shoqëri pasmoderne bëhet tipar mbizotërues pesimizmi problematik. Edhe studimet tregojnë se përgjigjet e anketuesve shprehin një perceptim se jeta e tyre po përkeqësohet.
- Etj.

3 pikë nëse shpjegon tre aspekte;

2 pikë nëse shpjegon dy aspekte;

1 pikë nëse shpjegon një aspekt;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

2 pikë

Model përgjigje

- Mjedisi shkollor është heterogjen, me nxënës të cilët vijnë nga sfonde të ndryshme nënkulturore, racore, etj. Në procesin e shoqërizimit nxënësit mësojnë të ndërveprojnë me të tjerët duke respektuar dhe toleruar të tjerët që janë ndryshe. Në këtë proces ata gjithashtu vetëdijësohen për kategorinë sociale në të cilën bëjnë pjesë.
- Në faza të ndryshme të ciklit shkollor nxënësit marrin njohuri të caktuara dhe kultivojnë aftësi të cilat vlerësohen të nevojshme për shoqërinë në të cilën jetojnë. Nxënësit mësojnë nga programi mësimor i planifikuar, por gjithashtu edhe nga programi mësimor i fshehtë në të cilin përvetësojnë vlerat kulturore më të rëndësishme, si ambicia për sukses, konkurrenca, etj.

2 pikë nëse shpjegon dy aspektet;

1 pikë nëse shpjegon një aspekt;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14

4 pikë

Model përgjigje

- Jo. Cilësimi i një sjellje si deviante është relative, ndryshon në kohë dhe në hapësirë.
- Një sjellje që cilësohet si deviante varet nga rrethanat kulturore, sociale, historike brenda një shoqërie të caktuar e që ndryshon nga një shoqëri në tjetrën. Asnjë veprim nuk është deviant në vetvete.
- Një vrasje konsiderohet krim në kushte paqe dhe krimet janë sjellje deviante. Në kushte lufte, vrasja e ushtarëve të palës në konflikt, vlerësohet dhe merr merita.
- Pirja e mariuhanës konsiderohet si sjellje deviante për shkak të paligjshmërisë, rreziqeve shëndetësore dhe stigmës sociale. Megjithatë në rrethana të ndryshuara, kur legjislativi e lejon përdorimin e moderuar, brenda grupeve nënkulturore të caktuara, pirja e mariuhanës mund të mos shihet si sjellje devijuese. Perceptimi shoqëror ndikohet nga normat shoqërore dhe ato ligjore të cilat dënojnë ose lejojnë përdorimin e moderuar të mariuhanës.
- Etj.

4 pikë nëse shpjegon karakterin relativ të deviancës dhe jep shembull;

3 pikë nëse evidenton karakterin relativ të deviancës dhe jep shembull;

2 pikë nëse shpjegon karakterin relativ të deviancës; nëse jep shembull;

1 pikë nëse evidenton karakterin relativ të deviancës;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15 **3 pikë**
Model përgjigje

- **Pabarazi ndërgjinore në punësim dhe të ardhura** – në shoqëritë e sotme është rritur numri i grave të punësuar, por për shkak të paragjyqimeve, janë në profesione më pak fitimprurëse se sa burrat. Madje edhe pagesa është më e ulët, për të njëjtën punë me burrat.
- **Punët e shtëpisë “turni i dytë” i grave** - Përkujdesi për shtëpinë, rritjen dhe mirëdukimin e fëmijëve konsiderohen akoma si “punë të grave”. Megjithëse shumica e grave punësohen jashtë ekonomisë familjare, ende janë të rënduara me detyrime të tilla. Angazhimi në punët e shtëpisë i pengon shumë vajza dhe gra të përparojnë në karrierën profesionale, politike e shoqërore.
- **Shpërpjesëtime ndërmjet arsimimit dhe punësimimit** - Sot, është rritur numri i grave që arsimohen, por për të njëjtin nivel arsimi, ngjitja në karrierë dhe pagat e larta janë për burrat. Sa më lart të ngjitesh në nivele karriere, më pak gra dhe vajza gjen. Shumica e profesioneve më të kualifikuara, më të mirëpaguara, më me prestigj dhe sidomos drejtimi i tyre është në duart e burrave.

3 pikë nëse përshkruan tre drejtime;

2 pikë nëse përshkruan dy drejtime;

1 pikë nëse përshkruan një drejtim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16 **3 pikë**
Model përgjigje

- Duke përdorur programe të ndryshme të teknologjisë po zëvendësohet puna që dikur kryente një llogaritar, ekonomist, etj., duke skualifikuar kështu disa pozicione pune.
- Përdorimi i kompjuterëve po bën që të shmangen kontaktet e drejtpërdrejta.
- Shumë procese pune kryhen online, po automatizohen dhe nuk ke kontakte me ofruesin e shërbimit.
- Kufizohet ndërveprimi i drejtpërdrejtë në vendin e punës.
- Rritet shkalla e mbikëqyrjes dhe kontrollit të punës duke përdorur teknikat kompjuterike.

3 pikë nëse vlerëson tre drejtime të ndryshimit në proceset e punës;

2 pikë nëse vlerëson dy drejtime të ndryshimit në proceset e punës;

1 pikë nëse vlerëson një drejtim të ndryshimit në proceset e punës;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë**
Model përgjigje

- Faza e parë, shfaqja e lëvizjes shoqërore. Lëvizja filloi si rrjedhojë e pakënaqësive, me kërkesën për të drejtat e njerëzve me ngjyrë. Në këtë fazë rritet ndërgjegjësimi për padrejtësitë racore dhe për të përkrahur ndryshime të caktuara shoqërore.
- Faza e dytë, masivizimi dhe organizimi. Rasti i Parks ndikoi që të organizohen protesta masive kundër segregacionit.
- Faza e tretë, burokratizimi. Lëvizja shoqërore karakterizohet nga burokratizimi ndërsa anëtarët bashkohen në organizimin e protestave. Udhëheqës karizmatik shfaqen dhe koordinojnë fushatat për të drejtat civile.
- Faza e katërt, rënia. Miratimi i legjisllacionit për t'i dhënë fund segregacionit ndikoi në fundin e lëvizjes, duke përmbushur kështu qëllimin e saj.

3 pikë nëse analizon tri faza;

2 pikë nëse analizon dy faza;

1 pikë nëse analizon një fazë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Filozofi

Pyetja 28 4 pikë

Model përgjigje

Qeverisja

- "Filozofët të bëhen mbret apo mbreti të bëhen filozof". Vetëm ajo klasë elitare e edukuar që njih të vërtetën mund të drejtojë.
- komuniteti organizohet sipas qëllimit të drejtësisë.
- kritik ndaj demokracisë qeverisjes demokratike që karakterizohet nga një liri e tepruar dhe beson se vetëm filozofët që karakterizohen nga virtyti dhe dija mund të drejtojnë në mënyrën e duhur.
- përmes bindjes së njerëzve ndaj ligjeve të vendit e gjithashtu duke bërë një reformë politike udhëhequr nga filozofët mund të arrihet një drejtësi.
- qeverisja të orientohet ndaj ndërgjegjësimit, jo kah dhunës.

Morali

- Politika duhet të jetë e lidhur me aspektin moral. Suksesi duhet të arrihet me mjete të denja.
- Qeverisja duhet të bazohet në parimet e moralit, etikës dhe jo sipas interesave vetjake.
- Shoqëria të ndjek virtytin përmes edukimit moral, mbretërit filozof të marrin vendime të bazuara në parime të qëndrueshme morale.

4 pikë nëse përshkruan dy tipare të qëndrimit platonian për politikën;

3 pikë nëse përshkruan një tipar të qëndrimit platonian për politikën dhe evidenton një tjetër tipar;

2 pikë nëse përshkruan një tipar të qëndrimit platonian për politikën; nëse evidenton dy tipare të qëndrimit platonian për politikën;

1 pikë nëse evidenton një tipar të qëndrimit platonian për politikën;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29

3 pikë

Model përgjigje

- Përmes këtij formulimi epikurianët kërkonin të largonin frikën nga vdekja, në mënyrë që njerëzit të jetonin jetën në plotësi e pa kufizime.
- Bazuar në këtë pohim, epikurianët konkludonin se Zoti nuk është krijues i botës.
- Zoti edhe nëse ekziston nuk kontrollon jetën e njerëzve. Për këtë arsye njerëzit nuk duhet të turbullohen nga frika prej perëndisë/ve.
- Nuk ekziston jeta e përtejme.
- Pas vdekjes nuk ka ndjesi, vdekja ekziston si koncept vetëm për tjetrin.
- Pas vdekjes atomet e trupit dhe mendjes ktheheshin në gjendjen fillestare për të krijuar sende e trupa të tjerë
- Iu kundërvunë supersticionit dhe orientuan vëmendjen ndaj një ftese për të gëzuar jetën.
- Promovonin të shijuarit e jetën përmes vetëkontrollit.
- Etj.

3 pikë nëse shpjegon tre qëndrime;

2 pikë nëse shpjegon dy qëndrime;

1 pikë nëse shpjegon një qëndrim;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30
Model përgjigje

3 pikë

- **Morali tradicional:** "Filozofi me çekiç" është metaforë që përfaqëson në mënyrë simbolike qëndrimin e tij kritik ndaj institucioneve dhe vlerave të pranuar. Niçe sulmoi shumë aspekte të kulturës dhe shoqërisë së kohës në shkrimet e tij. Disa nga sulmet më të njohura dhe më të rëndësishme të tij përfshijnë moralin tradicional. Niçe kundërshtoi vlerat dhe normat morale tradicionale dhe e përqendroi vëmendjen tek fuqia dhe vlerat e reja që i përkasin njerëzve të fuqishëm dhe origjinalë.
- **Besimi fetar:** Niçe kritikoi ashpër besimin tradicional, duke e konsideruar atë si shembull të moralit të rënë dhe një pengesë për zhvillimin individual dhe shoqëror. Ai shprehu kritika të forta ndaj konceptit të Zotit dhe moralit të bazuar në besime fetare, duke shfaqur nevojën për një "vdekje të Zotit" dhe një liri të re mendimi.
- **Mbinjeriu:** njeriu nuk mjaftohet me atë që është, ai zbulon në mënyrë të vazhdueshme një vete të re përtej asaj që është. Njeriu është e vetmja qenie e aftë të bëjë vetveten siç dëshiron dhe kjo përpjekje e çon atë në kërkim të mbinjeriut.
- Etj.

3 pikë nëse analizon tre aspektet;

2 pikë nëse analizon dy aspekte;

1 pikë nëse analizon një aspekt.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31
Model përgjigje

3 pikë

- - Shteti përmes monarkut ka sovranitetin absolut: Pushteti është absolut dhe i pandarë. Qytetarët janë të detyruar të respektojnë kontratën dhe t'i binden sovranit.
-Shteti i garanton njeriut disa të drejta, pasi në mënyrë vullnetare individët ia kanë deleguar ato pushtetit politik.
-Shteti është garantuesi i të drejtave dhe i jetës.
-Shteti garanton respektimin e kontratës sociale dhe ka autoritetin të ndëshkojë njerëzit që e shkelin atë.
-Autoriteti laik: Autoriteti sovran është laik, nuk rrjedh nga e drejta hyjnore.
-Shteti është një subjekt artificial: Shteti është një ent artificial, ai nuk gjendet në natyrë, por është krijuar nga qytetarët që delegojnë të drejtat nëpërmjet kontratës shoqërore.
- Monarkia absolute.

3 pikë nëse analizon dy tipare të shtetit dhe përcakton formën më të mirë të qeverisjes;

2 pikë nëse analizon dy tipare të shtetit; nëse analizon një tipar të shtetit dhe përcakton formën më të mirë të qeverisjes;

1 pikë nëse analizon një tipar të shtetit; nëse përcakton formën më të mirë të qeverisjes;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 32
Model përgjigje

4 pikë

Rilindja Evropiane:

- Në qendër, autoriteti i njeriut dhe besimi në arsyen e tij, ndryshe nga periudha e Mesjetës që në qendër kishte autoritetin e kishës dhe adhurimi ndaj Zotit.
- Zhvillimi i shkencës moderne me metoda empirike, ndryshe nga periudha e Mesjetës në të cilën shkencë mbështetej në dogmat fetare.
- Pasqyrim i humanizmit në filozofi në periudhën e Rilindjes, ndërsa në Mesjetë filozofia ishte në shërbim të teologjisë.

- Kozmosi perceptohej i pafund, me Diellin në qendër. Ndërsa në periudhën e Mesjetës, universi perceptohej i kufizuar, i krijuar nga Zoti, me në qendër Tokën.
- Arti, filozofia, kultura humaniste, kultivuan optimizmin dhe individualizmin. Në Mesjetë, arti dhe kultura ishin në shërbim të fesë, në qendër Zoti dhe shenjtorët.

Filozofia në periudhën e Rilindjes

- Filozofia në periudhën e Rilindjes u zhvillua e çliruar nga paragjykimet dhe autoritetet.
- Filozofia filloi të interpretonte gjithçka në këndvështrim të ri.
- Filozofia e Rilindjes theksoi rolin e arsyes njerëzore dhe vlerësimit kritik të dogmës fetare.
- U trajtuan me përparësi temat morale dhe politike të cila lidhen me konceptin e lirisë, të drejtave të njeriut etj.

- 4 pikë** nëse përshkruan dy karakteristika të Rilindjes që e dallojnë nga Mesjeta dhe dy karakteristika të filozofisë së Rilindjes;
- 3 pikë** nëse përshkruan dy karakteristika të Rilindjes që e dallojnë nga Mesjeta dhe një karakteristika të filozofisë së Rilindjes; nëse përshkruan një karakteristike të Rilindjes që e dallon nga Mesjeta dhe dy karakteristika të filozofisë së Rilindjes;
- 2 pikë** nëse përshkruan dy karakteristika të Rilindjes që e dallojnë nga Mesjeta; nëse përshkruan një karakteristike të Rilindjes që e dallon nga Mesjeta dhe një karakteristike të filozofisë së Rilindjes;
- 1 pikë** nëse përshkruan një karakteristike të Rilindjes që e dallon nga Mesjeta; nëse përshkruan një karakteristike të filozofisë së Rilindjes;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

3 pikë

Model përgjigje

- Për Kirkegardin gjendja e ankthit do të thotë të kesh humbur siguri politike, filozofike etj. Ankthi që vjen nga liria, e vendos njeriun në një situatë ekzistenciale, ku duhet vazhdimisht të bëjë zgjedhje, të vlerësojë mundësitë, të angazhohet.
- Stadi fetar bashkon njeriun me krijuesin e tij dhe ka të bëjë me lidhjen personale që krijohet me Zotin. Në këtë stad vendoset për besimin edhe pse pa pasur një siguri. Njeriu merr angazhim dhe përgjegjësi për jetën e tij. Natyra esenciale e njeriut e lidh atë me krijuesin.
- Stadi etik, është stadi i angazhimit dhe besnikërisë. Shumë gjëra nga stadi estetik tashmë nuk i japin kënaqësi. Njeriu përballet me sfidat e jetës dhe kërkon të bëhet i pranueshëm për shoqërinë duke iu nënshtruar jetës dhe kapërcyer veçantitë individuale.

3 pikë nëse analizon tre konceptet;

2 pikë nëse analizon dy konceptet;

1 pikë nëse analizon një koncept;

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.
